



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI I MJEKËSISË, TIRANË
NJËSIA E PROKURIMIT

Nr. _____prot.

Tiranë, më _____.____.2026

PROCESVERBAL- Tipi i kontratës - Mallra

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE
DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

**OBJEKTI I PROCEDURËS: “BLERJE PAJISJE MOBILIMI PËR NJËSITË SHPENZUESE
TË UNIVERSITETIT TË MJEKËSISË, TIRANË”**

**MARRËVESHJE KUADËR ME NJE OPERATORË EKONOMIK, KU TË GJITHA KUSHTET
JANË TË PËRCAKTUARA**

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT(CPV): 39100000-3 -
Mobilje, 39130000-2 - Mobilje për zyra, 39150000-8 - Mobilje dhe pajisje të ndryshme.**

VLERA E FONDIT LIMIT: Fondi limit: Fondi limit total i marrëveshjes kuadër 12-mujore është **112,103,157 (njëqind e dymbëdhjetë milion e njëqind e tre mijë e njëqind e pesëdhjetë e shtatë) lekë pa TVSH dhe 1,192,079.5 (një milion e njëqind e nëntëdhjetë e dy mijë e shtatëdhjetë e nëntë pikë pesë) Euro pa TVSH,** i ndarë si më poshtë vijon:

- Fakulteti i Mjekësisë 103,124,389 (njëqind e tre milion e njëqind e njëzet e katër mijë e treqind e tetëdhjetë e nëntë) lekë pa TVSH dhe 1,096,601.3 (një milion e nëntëdhjetë e gjashtë mijë e gjashtëqind e një pikë tre) Euro pa TVSH.
- Fakulteti i Mjekësisë Dentare 813,536 (tetëqind e trembëdhjetë mijë e pesëqind e tridhjetë e gjashtë) lekë pa TVSH dhe 8,651 (tetë mijë e gjashtëqind e pesëdhjetë e një) Euro pa TVSH.
- Rektorati i Universitetit të Mjekësisë, Tiranë 8,165,232 (tetë milion e njëqind e gjashtëdhjetë e pesë mijë e dyqind e tridhjetë e dy) lekë pa TVSH dhe 86,827.2 (tetëdhjetë e gjashtë mijë e njëzetë e shtatë pikë dy) Euro pa TVSH.

***Shënim:** Vlerat në Lekë janë konvertuar në monedhën Euro sipas kursit zyrtar të këmbimit të Bankës së Shqipërisë me datë 08.07.2026, me kurs këmbimi 94.04 (nëntëdhjetë e katër pikë katër) lekë.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të

prokurimit publik”, të ndryshuar Autoriteti Kontraktor Universiteti i Mjekësisë Tiranë ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 9;

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;

Argumentimi: Kriteret e mësipërme janë vendosur në përputhje me Nenin 82 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” dhe Neni 83 “Sigurimi i ofertës”, të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar si dhe në mbështetje të nenit 26, nenit 30, pika 1, të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar. Neni 83 “Sigurimi i ofertës” i LPP-së në të cilën është e përcaktuar se: “Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël”, Neni 82 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”, i LPP-së përcaktohet se: “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik”.

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Ofertuesi duhet të deklarojë se përmbush kriteret e përgjithshme të pranimit/kualifikimit. Këto kriteret duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 9.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 76 “Kriteret detyruese për skualifikim” të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar dhe nenit 25 “Kriteret e kualifikimit” të VKM-se nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Për të provuar se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën, duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare

(2023, 2024, 2025), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e përlllogaritur e fondit limit. Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është në nenin 77 “Kërkesat për kualifikim”, pika 3 të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, në të cilin gjejmë të përcaktuar se: 3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën. Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës/ lotit” bazuar në nenin 43 “Kërkesat për kapacitetet ekonomiko-financiare”, pika 2/a dhe nenin 47 “Procedura e hapur” të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në pikën 2 të nenit 61, të Ligjit nr.29/2023 “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar ku përcaktohet se: “Deklarata tatimore vjetore dorëzohet në organin tatimor jo më vonë se data 31 mars e vitit pasardhës të vitit tatimor për të cilin dorëzohet deklarata”. Vendosja e këtij kriteri bëhet me qëllim krijim e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, për aftësinë ekonomike dhe financiare të operatorëve ekonomik ofertues, duke vërtetuar nëpërmjet dokumenteve të kërkuara, se zotërojnë kapacitet ekonomik dhe financiar për të përmbushur kontratën sic është parashikuar nga Autoriteti Kontraktor.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Vlera e kërkuar jo më e vogël se vlera e fondit limit të kontratës/lotit që prokurohet është në përputhje me përcaktimet në nenin 43 “Kërkesat për kapacitetet ekonomiko-financiare” pika 2/a të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar, ku përcaktohet se: “Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë: b) vlerën e përlllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar”. Në rastin konkret nga ana e Njesisë së Prokurimit është konsideruar e arsyeshme që vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e fondit limit, me qëllim nxitjen e pjesëmarrjes së operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik, nxitjen e konkurrencës ndërmjet operatorëve ekonomikë si edhe të sigurimit të një trajtimi të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë ofertuesit e mundshëm ekonomikë. Duke patur parasysh, përcaktimin e bërë në nenin 43 “Kërkesat për kapacitetet ekonomiko-financiare” pika 2/b, kjo vlerë është kërkuar duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumin e saj, që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorit ekonomik, të cilët duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme ekonomike dhe financiare, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë **dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit** nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në vlerën jo më pak se 39 % e vlerës së fondit limit. Këto furnizime të mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:

- a) *Autoriteti/enti kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruar në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.*
- b) *Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruar në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.*

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 “Kërkesat për kualifikim” pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar nenit 40 “Kërkesa të veçanta për kontratat e mallrave” pika 4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar, ku përcaktohet se: “Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në çdo rast, vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.” Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e ngjashme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 40 % të vlerës së fondit limit për të paktën një kontratë të vetme. Përqindja e kërkuar është konsideruar e nevojshme për të provuar besueshmërinë dhe provojën e operatorëve ekonomik ofertues, në ofrimin e mallrave të ngjashëm me objektin e prokurimit për realizimin me sukses të kontratës.

2.3.2 Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë të punësuar të paktën 25 (njëzet) punonjës të cilët duhet të figurojnë në listpagesën e shoqërisë për 3 muajt e fundit nga data e publikimit të procedurës, vërtetuar me:

- Vërtetim të lëshuar nga autoritetet përkatëse ku të specifikohet numri i punonjësve për 3 muajt e fundit nga data e publikimit të procedurës.
- Listpagesat e punonjësve të konfirmuara nga autoritetit përkatës sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi minimumi për 3 muajt e fundit nga data e publikimit të procedurës.

*Përmbushja e kësaj kërkesë në fazën e ofertimit do të bëhet nëpërmjet dorëzimit të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit sipas shtojcës nr. 9, siç parashikohet edhe nga pika 1 e nenit 26 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar. Dokumentacioni i përshkruar në këtë pikë do të dorëzohet nga operatori i kualifikuar i pari, kjo në

mbështetje të pikës 6 të nenit 26 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar. Operatori ekonomik i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit duhet të paraqesë të gjithë dokumentacionin provues të kërkuar si më sipër.

Argumentimi: Në bazë të nenit 77, “Kërkesat për kualifikim”, të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020, “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, si dhe nenit 40, pika 5/b/c, “Kërkesa të veçanta për kontratat e mallrave”, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar;

Kërkesa prej 25 punonjësish është kërkuar me qëllim që operatori të disponojë fuqi punëtore e cila do të kryejë të gjitha veprimtaritë të cilat krijojnë kushtet e përshtatshme për montimin e mobiljeve të reja objekt kontrate. Transporti dhe dhënia e ndihmës për montimin e mobiljeve të reja, si dhe çdo proces ndihmës në funksion të zbatimit të kontratës me sukses. Gjithsesi, ky numër punonjësish është minimal që operatori ekonomik ofertues, jo vetëm prodhues por edhe tregëtues, duhet të kenë për zbatimin e kontratës. Kjo krijon bindjen e Autoritetit Kontraktor se operatori ekonomik duke patur një staf të kualifikuar, garanton produkte përfundimtare cilësore, të qëndrueshme dhe jetëgjatë, të punuara në përputhje të plotë me sipeçifikimet teknike dhe me standartet e kërkuara në dokumentet e tenderit.

Ekzekutimi i kontratës për furnizimin me mobilje përfshin procese të njëkohshme prodhimit, përpunimit, kontrollit të cilësisë, transportit dhe montimit në vendet e përcaktuara nga Autoritetet Kontraktore përfituese. Bazuar në afatin e përcaktuar për realizimin e minikontratave (sistemimi i laboratorëve për vitin e ri shkollor 2026-2027), operatori ekonomik duhet të disponojë burime njerëzore të mjaftueshme për të kryer paralelisht të gjitha proceset e nevojshme dhe për të garantuar përfundimin e furnizimit dhe montimit brenda afatit kontraktor. Numri minimal prej 30 punonjësish vlerësohet i nevojshëm për të siguruar kapacitetet prodhuese, logjistike dhe teknike të operatorit ekonomik, si dhe për të garantuar cilësinë dhe respektimin e afateve të zbatimit.

Ky kriter është proporcional me natyrën e kontratës, afatin e realizimit dhe nevojën për ekzekutimin e saj në kohë dhe me cilësi, duke synuar verifikimin e aftësisë reale të operatorëve ekonomikë për përmbushjen e detyrimeve kontraktore.

2.3.3 Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar ne stafin e tij dhe të figurojnë në listëpagesat e operatorit 3 muajt e fundit nga data e publikimit të procedurës, punonjësit e mëposhtëm:

- **1 (një) inxhinier druri**

Për plotësimin e këtij kriteri operatori ekonomik duhet të paraqesë:

- a. kontratën individuale të punës
- b. diplomën, që të vërtetojë kualifikimin profesional të mësipërm.

- **1 (një) arkitekt**

Për plotësimin e këtij kriteri operatori ekonomik duhet të paraqesë:

- a. kontratën individuale të punës
- b. diplomën, që të vërtetojë kualifikimin profesional të mësipërm.

- **5 (pesë) marangoz / mobilier**

Për plotësimin e këtij kriteri operatori ekonomik duhet të paraqesë:

- a. kontratën individuale të punës;
- b. diplomë/dëftesë/dëshmi që vërteton nivelin e kualifikimit arsimor, lëshuar nga institucione publike/private të licencuara sipas ligjit nr. 15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar;

- **2 (dy) Bojaxhi/Llustrues** për prodhime druri.

Për plotësimin e këtij kriteri operatori ekonomik duhet te paraqesë:

- a. kontratën individuale të punës;
- b. diplomë/dëftesë/dëshmi që vërteton nivelin e kualifikimit arsimor, lëshuar nga institucione publike/private të licencuara sipas ligjit nr.15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar;

- **3 (tre) shofer** vërtetuar me:

- a. Kontratën individuale të punës
- b. Lejedrejtimi përkatëse

- **5 (pesë) punonjës të thjeshtë/punëtor përpunues druri** për veprimtari ndihmëse për marangozët/mobilierët gjatë proceseve të punës vërtetuar me:

- a. Kontratën individuale të punës

Punonjësit e tjerë mund të jenë të profileve të ndryshme si punonjës teknik, punonjës ngarkim shkarkimi dhe staf ndihmës.

*Përmbushja e kësaj kërkesë në fazën e ofertimit do të bëhet nëpërmjet dorëzimit të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit sipas shtojcës nr. 9, siç parashikohet edhe nga pika 1 e nenit 26 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar. Dokumentacioni i përshkruar në këtë pikë do të dorëzohet nga operatori i kualifikuar i pari, kjo në mbështetje të pikës 6 të nenit 26 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar. Operatori ekonomik i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit duhet të paraqesë të gjithë dokumentacionin provues të kërkuar si më sipër.

Argumentimi: Në bazë të nenit 77, “Kërkesat për kualifikim”, të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020, “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, si dhe nenit 40, pika 5/b/c, “Kërkesa të veçanta për kontratat e mallrave”, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, në mbështetje të Ligjit nr. 15/2017,

“Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të Vendimit nr. 514, datë 20.09.2017, “Për miratimin e listës kombëtare të profesioneve (LKP) të rishikuar”, si dhe të Urdhrit nr. 99, datë 25.05.2021, “Për miratimin e katalogut kombëtar të kualifikimeve profesionale”, është parashikuar kriteri që operatorët ekonomikë të dëshmojnë disponimin e stafit dhe personelit të nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Kërkesa për punonjës të specializuar lidhet drejtpërdrejt me objektin e prokurimit, pasi një pjesë e konsiderueshme e artikujve të kërkuar përbëhet nga mobilje druri ose materiale të ngjashme, të cilat do të prodhohen, montohen dhe asamblosen në përputhje të plotë me përmasat dhe specifikimet teknike të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Specifikimet teknike përfaqësojnë elementët kryesorë që garantojnë cilësinë e produkteve dhe përmbushjen e funksioneve të kërkuara nga Autoriteti Kontraktor. Në këtë mënyrë, argumentimi për domosdoshmërinë e stafit të kualifikuar bazohet në sigurimin e një realizimi cilësor të objektit të prokurimit, duke garantuar jo vetëm përputhjen me kuadrin ligjor dhe rregullator, por edhe me kërkesat funksionale dhe estetike të Autoritetit Kontraktor përfitues.

- 1 (një) inxhinier druri, vërtetuar me kontratën individuale të punës dhe diplomën, që të vërtetojë kualifikimin profesional të mësipërm.

Sigurimi i cilësisë, qëndrueshmërisë dhe plotësimi i standardeve të produkteve. Përfshirja e një inxhinieri druri në këtë procedurë është thelbësore për garantimin e cilësisë dhe përputhjes së produkteve me kërkesat teknike të përcaktuara. Një inxhinier druri zotëron aftësitë dhe njohuritë e nevojshme për të analizuar, përzgjedhur dhe trajtuar materialet e drurit, duke siguruar që mobiljet të jenë të qëndrueshme, rezistente dhe të përshtatshme për përdorim afatgjatë. Ai ka kompetencën për të vlerësuar lëndët e para nëse përmbushin standardet dhe specifikimet e kërkuara, si dhe për të garantuar që produkti përfundimtar të arrijë nivelin e cilësisë së kërkuar nga Autoriteti Kontraktor.

Mobiljet e përfshira në këtë objekt prokurimi kanë standarde të përcaktuara për cilësinë, sigurinë dhe funksionalitetin. Një inxhinier druri zotëron njohuritë profesionale të nevojshme për të zbatuar këto standarde gjatë gjithë procesit të prodhimit. Ai është i kualifikuar për të dhënë zgjidhje teknike mbi konstruksionet më të përshtatshme, të cilat sigurojnë stabilitetin, estetikën dhe qëndrueshmërinë e produkteve, duke ndihmuar njëkohësisht në mbikëqyrjen e elementeve të sigurisë, në mënyrë që produktet përfundimtare të mos paraqesin rrezik për përdoruesit.

Rëndësia e kërkesës për personel të kualifikuar, në veçanti për një inxhinier druri, qëndron në garantimin e cilësisë së produkteve dhe në sigurimin e përputhjes së tyre me specifikimet teknike të tenderit. Kjo jo vetëm që ul kostot e mundshme nga defektet ose mospërputhjet, por gjithashtu siguron që Autoriteti Kontraktor përfitues të ketë produkte të qëndrueshme, të sigurt dhe të përshtatura me nevojat e tij funksionale dhe mjedisore. Ky kriter është i detyrueshëm vetëm në rastet kur operatori ekonomik ofertues është prodhues.

- 1 arkitekt Për shkak të natyrës së veçantë të kontratës, që përfshin mobilimin e ambienteve funksionale dhe institucionale, është e nevojshme përfshirja e një arkitekti në stafin teknik të

operatorit ekonomik. Arkitekti do të sigurojë që zgjidhjet e mobilimit të jenë në përputhje me hapësirat ekzistuese, funksionale dhe estetike, si dhe do të ndjekë me përpikmëri zbatimin e projektit dhe respektimin e specifikimeve teknike gjatë gjithë fazës së realizimit të kontratës. Ai zotëron njohuritë e nevojshme për përzgjedhjen e materialeve, veçanërisht të drurit, duke garantuar që mobiljet të jenë të qëndrueshme dhe të përshtatshme për përdorim afatgjatë. Gjithashtu, ka kompetencën për të vlerësuar përputhshmërinë e zgjidhjeve me standardet dhe kërkesat teknike të Autoritetit Kontraktor, duke siguruar cilësi të lartë të produktit përfundimtar.

- **5 (pesë) marangozë**, vërtetuar me kontratën individuale të punës dhe diplomë/dëshmi që vërteton nivelin e kualifikimit arsimor, lëshuar nga institucione publike/private të licencuara sipas ligjit nr.15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar;

- **2 (dy) Bojaxhi/Llustrues për prodhime druri**, vërtetuar me kontratën individuale të punës dhe diplomë/dëftesë/dëshmi që vërteton nivelin e kualifikimit arsimor, lëshuar nga institucione publike/private të licencuara sipas ligjit nr.15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar;

Marangozi, mobilieri, apo Bojaxhiu/Llustrues për prodhime druri zotëron njohuritë e nevojshme për përpunimin dhe montimin e saktë të pjesëve përbërëse të mobiljeve. Ky specialist është i aftë të zbatojë me saktësi udhëzimet teknike dhe të sigurojë që çdo element i montuar të jetë në përputhje të plotë me specifikimet e kërkuara në dokumentet e tenderit. Përfshirja e tij është thelbësore për shmangien e gabimeve që mund të cenojnë cilësinë dhe jetëgjatësinë e mobiljeve, duke reduktuar rrezikun e defekteve dhe problemeve gjatë përdorimit. Cilësia, stabiliteti dhe siguria janë elementë kritikë për mobiljet e destinuara për përdorim në ambiente publike, pasi një montim i gabuar mund të krijojë rrezik për sigurinë e punonjësve dhe përdoruesve. Ky specialist siguron gjithashtu që montimi, asamblimi dhe çdo proces tjetër i punës të realizohen në përputhje të plotë me specifikimet teknike të kërkuara, duke garantuar funksionalitetin, sigurinë dhe përshtatjen e mobiljeve me qëllimin për të cilin janë prokuruar.

- **3 (tre) shofer** vërtetuar me kontratën individuale të punës dhe leje drejtimi, e vlefshme;

Tre shoferë janë të domosdoshëm për realizimin e transportit dhe kryerjen e punëve ndihmëse përgjatë të gjithë proceseve të zbatimit të kontratës. Duke qenë se mjetet e transportit mund të jenë si në pronësi, ashtu edhe me qira, në çdo rast është e domosdoshme siguri i personelit të kualifikuar dhe të disponueshëm, në mënyrë që të garantohet vijueshmëria pa ndërprerje e punës dhe realizimi me sukses i kontratës.

- 5 (pesë) punonjës të thjeshtë/punëtor përpunues druri për veprimtari ndihmëse për marangozët/mobilierët si dhe punonjësit e tjerë të profileve të ndryshme si punonjës teknik dhe staf ndihmës.

Për shkak të natyrës së veçantë të kontratës si dhe volumit të saj, që përfshin mobilimin e disa godinave në funksion të studentëve (laborator mësimor si dhe ambiente funksionale dhe institucionale), është e nevojshme angazhimi i stafit teknik dhe ndihmës të profileve të ndryshme

për mbulimin e veprimtararive ndihmëse (ngarkim-shkarkim) si dhe përpunim, montim të mobiljeve, Stafi i kërkuar do të jetë në funksion të personelit të mësipërm (magarngoz/mobilier) për realizimin brenda afateve të kërkuara.

2.3.4 Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë i pajisur dhe të paraqesë çertifikata të lëshuara nga organizmat e vlerësimit të konformitetit, të akredituara nga organizmi kombëtar akreditues, ose organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, në përputhje me objektin e prokurimit, si më poshtë:

- ISO 9001:2015 “*Mbi sistemet e menaxhimit të cilësisë* ” (e vlefshme) ose ekuivalent;
- ISO 14001:2015 “*Mbi Sistemet e menaxhimit të mjedisit*” (e vlefshme) ose ekuivalent;
- ISO 45001:2018 “*Për Sistemin i Menaxhimit të Shëndetit dhe Sigurisë në Punë*” (e vlefshme) ose ekuivalent.

Argumentimi: Ky kriter është vendosur në përputhje me pikën 1 të nenit 79 të Ligjit nr. 162/2020, “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar, ku përcaktohet se autoriteti ose enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet objekt prokurimi plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve paraqitjen e certifikatave të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose nga organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. E njëjta dispozitë zbatohet edhe kur kërkesat teknike lidhen me kualifikimet e kandidatit apo ofertuesit. Gjithashtu, ky kriter mbështetet në pikën 1 të nenit 44 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar, ku përcaktohet se autoriteti/enti kontraktor mund t’u kërkojë ofertuesve paraqitjen e certifikatave të tilla vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtë me objektin e prokurimit. Ky kriter është vendosur për të garantuar njohjen e kapacitetit të operatorëve ekonomikë dhe për të vlerësuar aftësinë e tyre teknike dhe profesionale në drejtim të furnizimit me artikuj cilësorë, të prodhuar ose të hedhur në treg sipas standardeve ndërkombëtare.

ISO 9001 ose ekuivalent përcakton kërkesat për një sistem menaxhimi të cilësisë dhe mund të zbatohet nga çdo shoqëri, pavarësisht përmasave apo fushës së aktivitetit. Duke parë objektin e kësaj procedure prokurimi, Autoriteti Kontraktor vlerëson të nevojshme që operatorët ekonomikë të jenë të pajisur me këtë certifikatë, në mënyrë që furnizimi të kryhet me cilësinë dhe brenda afateve të kërkuara.

ISO 14001 ose ekuivalent garanton që operatori ekonomik ka ndërmarrë masa proaktive për të minimizuar ndikimin negativ në mjedis, si dhe zbaton kuadrin rregullator për mbrojtjen e tij. Ky standard ndihmon në reduktimin e mbetjeve, kursimin e energjisë dhe uljen e kostove, duke sjellë përfitime të prekshme për institucionin dhe mjedisin.

ISO 45001 ose ekuivalent është një standard ndërkombëtar që përcakton kërkesat për sistemin e menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë. Ai ofron një kornizë për të menaxhuar rreziqet, për

të ulur incidentet dhe lëndimet në vendin e punës dhe për të dëshmuar përkushtimin e operatorit ekonomik ndaj shëndetit dhe sigurisë së punonjësve të tij.

Në përfundim, vendosja e këtij kriteri siguron që operatorët ekonomikë të jenë të certifikuar sipas standardeve të njohura ndërkombëtare, duke garantuar cilësinë, sigurinë, mbrojtjen e mjedisit dhe realizimin me sukses të objektit të prokurimit.

2.3.5 Operatori ekonomik duhet të disponojë minimumi 3 (tre) mjete transporti mallrash i përshtatshëm për transport të këtyre lloj artikujve, me kapacitet mbajtës min 3.5 ton . Mjetet e transportit mund të jenë në pronësi ose me qera.

-Kur mjetet janë në pronësi, duhet të paraqitet:

- ☐ Çertifikatë pronësie
- ☐ Leje qarkullimi
- ☐ Çertifikatë e kontrollit teknik
- ☐ Policë sigurimi

-Kur mjetet janë marrë me qira, duhet të paraqitet kontrata e qirasë dhe dokumentat e mëposhtme:

- ☐ Çertifikatë pronësie
- ☐ Leje qarkullimi
- ☐ Çertifikatë e kontrollit teknik
- ☐ Policë sigurimi

*Përmbushja e kësaj kërkesë në fazën e ofertimit do të bëhet nëpërmjet dorëzimit të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit sipas shtojcës nr. 9, siç parashikohet edhe nga pika 1 e nenit 26 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar. Dokumentacioni i përshkruar në këtë pikë do të dorëzohet nga operatori i kualifikuar i pari, kjo në mbështetje të pikës 6 të nenit 26 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar. Operatori ekonomik i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit duhet të paraqesë të gjithë dokumentacionin provues të kërkuar si më sipër.

Argumentimi: Në bazë të nenit 77 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020, “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar), si dhe nenit 40, pika 5/ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (e ndryshuar), është përcaktuar ky kriter, me anë të të cilit kërkohet që operatorët ekonomikë të garantojnë Autoritetin Kontraktor se disponojnë mjetet e nevojshme të transportit dhe se do të kryejnë shpërndarjen e mallrave objekt prokurimi në adresat e përcaktuara nga Autoriteti Kontraktor përfitues. Vendosja e këtij kriteri synon të sigurojë që operatori ekonomik të garantojë shërbimin e transportit në kohë dhe në përputhje me afatet e kontratës, duke pasur parasysh se një pjesë e mallrave do të shpërndahen pranë vendndodhjes së AK.

Kërkesa për të pasur në dispozicion minimumi tre mjete transporti është përcaktuar në mënyrë proporcionale me sasinë e mallrave të kërkuar dhe me vendndodhjen e Autoritetetve Kontraktore përfituese, ku këto mallra do të depozitohen. Ky kusht garanton sigurinë, vijueshmërinë dhe cilësinë e shërbimit të transportit, duke ulur rrezikun e vonesave ose ndërprerjeve në procesin e furnizimit.

2.3.6 Operatori ekonomik duhet të disponojë makineritë dhe pajisjet e mëposhtme:

- Makineri prerëse automatike kompjuterike (ose ekuivalent i saj)
- Bordatrice (ose ekuivalent i saj)
- Pantograf CNC (punime të ndryshme dhe forimi për mobiljet e kërkuara), (ose ekuivalent i saj)
- Dhome lyerje (kabina lyerje për mobilje)
- Makineri Frezë (ose ekuivalent i saj)
- Presë multifunksionale (ose ekuivalent i saj)

Disponimi i makinerive dhe pajisjeve të mësipërme duhet të provohet me faturë blerje/akt zhdoganimi/kontratë qiraje ose huapërdorje noteriale ose me çdo mënyrë tjetër të njohur nga aktet ligjore në fuqi. Në çdo rast autoriteti ka të drejtë të verifikojë vërtetësinë e makinerive të paraqitura duke kryer verifikimet në terren dhe çdo konstatim i ndryshëm nga ai i deklaruar nga operatori, do çojë në skualifikimin e ofertës së tij.

*Përmbushja e kësaj kërkesë në fazën e ofertimit do të bëhet nëpërmjet dorëzimit të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit sipas shtojcës nr. 9, siç parashikohet edhe nga pika 1 e nenit 26 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar. Dokumentacioni i përshkruar në këtë pikë do të dorëzohet nga operatori i kualifikuar i pari, kjo në mbështetje të pikës 6 të nenit 26 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar. Operatori ekonomik i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit duhet të paraqesë të gjithë dokumentacionin provues të kërkuar si më sipër.

Argumentimi: Në bazë të nenit 77 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020, “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar), si dhe nenit 40, pika 5/ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (e ndryshuar), është përcaktuar ky kriter, me anë të të cilit kërkohet që operatorët ekonomikë të garantojnë Autoritetin Kontraktor se disponojnë mjetet e nevojshme të kryejnë prodhimin e mallrave objekt prokurimi.

Makineria prerëse automatike kompjuterike kërkohet për të garantuar kapacitetin teknik të operatorit ekonomik në realizimin e mobiljeve me përmasa të sakta, cilësi të qëndrueshme dhe brenda afateve të kontratës. Përdorimi i kësaj makinerie siguron proces prodhimi të automatizuar, minimizon gabimet gjatë prerjes së materialeve dhe rrit efikasitetin në përmbushjen e sasive të kërkuara nga autoritetet kontraktore përfituese.

Makineria bordatrice kërkohet për realizimin e procesit të bordimit të paneleve që përdoren në prodhimin e mobiljeve. Përdorimi i saj garanton cilësi të lartë të përfundimit të produkteve,

qëndrueshmëri më të madhe të mobiljeve, si dhe realizimin e punimeve me saktësi dhe efikasitet brenda afateve të kontratës. Kjo pajisje është e nevojshme për të siguruar standardet teknike dhe estetike të mobiljeve objekt prokurimi."

Pantografi CNC është një makineri e kontrolluar nga kompjuteri që përdoret për prerjen, shpimin, gdhendjen, frezimin dhe formimin e elementeve të ndryshme të mobiljeve me saktësi të lartë. Kjo pajisje mundëson realizimin e punimeve të ndryshme në panele druri, MDF, melaminë dhe materiale të tjera që përdoren në prodhimin e mobiljeve. Kërkesa për disponimin e një Pantografi CNC argumentohet me nevojën për të garantuar kapacitetin teknik të operatorit ekonomik në realizimin e mobiljeve sipas specifikimeve teknike të kërkuara. Përdorimi i kësaj makinerie siguron saktësi dimensionale, cilësi të lartë të përpunimit, realizimin e formave dhe elementeve të veçanta konstruktive, si dhe rritjen e produktivitetit dhe respektimin e afateve të kontratës. Pantografi CNC është i domosdoshëm për kryerjen e proceseve të përpunimit dhe formimit të komponentëve të mobiljeve, duke garantuar uniformitet, cilësi dhe përfundim profesional të produkteve objekt prokurimi.

Kabina e lyerjes është e domosdoshme për realizimin e procesit të lyerjes së mobiljeve në kushte të kontrolluara teknike dhe të sigurisë. Në rastin konkret kemi tavolina dhe rafte të cilat janë me material mdf dhe kanë nevojë për një finiturë me ngjyrë (ngjyra do të përcaktohet në momentin e lidhjes së kontratës sipas konceptit të arredimit të zyrës). Përdorimi i saj siguron cilësi më të lartë të lyerjes, redukton praninë e pluhurit dhe papastërtive në sipërfaqet e lyera, si dhe mundëson largimin e avujve dhe grimcave të bojës përmes sistemit të ventilimit. Kjo ndikon në përmirësimin e cilësisë së produktit përfundimtar, rritjen e sigurisë dhe shëndetit në punë të punonjësve, si dhe respektimin e standardeve teknike dhe mjedisore në procesin e prodhimit të mobiljeve.

Makineria frezë është një pajisje për përpunimin mekanik të materialeve që përdoren në prodhimin e mobiljeve, si druri, MDF, melamina dhe materiale të ngjashme. Ajo shërben për realizimin e kanaleve, profileve, brazdave, formave dekorative dhe elementeve të ndryshme konstruktive të nevojshme për montimin dhe përfundimin e mobiljeve.

Kërkesa për disponimin e një makinerie frezë argumentohet me nevojën për të garantuar kapacitetin teknik të operatorit ekonomik për realizimin e proceseve të përpunimit me saktësi dhe cilësi të lartë. Përdorimi i saj mundëson përpunimin e elementeve të mobiljeve sipas dimensioneve dhe specifikimeve teknike të kërkuara, duke siguruar përfundim cilësor, funksionalitet dhe qëndrueshmëri të produkteve. Makineria frezë kontribuon në rritjen e produktivitetit, reduktimin e gabimeve gjatë prodhimit dhe garantimin e përmbushjes së kontratës brenda afateve të përcaktuara, duke përbërë një element të rëndësishëm të kapacitetit teknik të operatorit ekonomik

Presja multifunksionale është një pajisje që përdoret në procesin e prodhimit të mobiljeve dhe dyerve për presimin, ngjitjen dhe formimin e elementeve të ndryshme prej druri, MDF-je, dhe materialeve të tjera të ngjashme. Kjo makineri siguron ushtrimin e presionit të njëtrajtshëm mbi sipërfaqet që përpunohen, duke garantuar cilësi dhe qëndrueshmëri të lartë të produkteve të përfunduara. Presja multifunksionale kërkohet për të garantuar kapacitetin teknik të operatorit ekonomik në realizimin e proceseve të prodhimit dhe montimit të mobiljeve sipas specifikimeve teknike të kërkuara. Përdorimi i saj mundëson ngjitje të qëndrueshme të materialeve, formim të saktë të elementeve përbërëse dhe përmirësim të cilësisë strukturore të mobiljeve. Kjo pajisje ndikon drejtpërdrejt në cilësinë, rezistencën dhe jetëgjatësinë e produkteve, si dhe në rritjen e

efikasitetit të procesit të prodhimit, duke mundësuar përmbushjen e kontratës brenda afateve të përcaktuara dhe sipas standardeve të kërkuara nga autoriteti kontraktor.

Kërkesa për të pasur në dispozicion këto mjete është përcaktuar në mënyrë proporcionale me sasinë e mallrave dhe kohës së levrimit, pasi keto pajisje lejojnë realizimin e proceseve të përpunimit me precizion të lartë, garantimin e uniformitetit dhe përshtatshmërisë së produkteve, si dhe përmbushjen e kërkesave të kontratës në mënyrë të qëndrueshme dhe efikase. Mungesa e këtyre makinerive mund të ndikojë direkt në cilësinë e prodhimit dhe në aftësinë për të përmbushur specifikimet e detajuara teknike.

2.3.7 Operatori Ekonomik Ofertues duhet të paraqesë një deklaratë për periudhën minimale 1 vjeçare të garancisë së mallrave objekt prokurimi, nga data e dorëzimit të mallit, gjatë së cilës ofertuesi do të sigurojë riparimin e defekteve për shkak të prodhimit dhe montimit.

Argumentimi: Ky kriter është përcaktuar në përputhje me nenin 77, pika 4, të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020, “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar), si dhe pikën 8 të nenit 40 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. Përmes këtij kriteri synohet që operatorët ekonomikë të marrin përsipër detyrimin e qartë për të garantuar cilësinë e mallrave të furnizuara, duke dhënë një periudhë garancie minimale dyvjeçare.

Deklarata e garancisë shërben si instrument ligjor dhe kontraktor për Autoritetin Kontraktor, duke garantuar se mallrat e dorëzuara janë në përputhje të plotë me specifikimet teknike të përcaktuara në DST. Në rast të defekteve të shkaktuara nga prodhimi, cilësia apo montimi, të ndodhura brenda periudhës së garancisë, operatori ekonomik ka detyrimin ligjor dhe kontraktor të kryejë menjëherë riparimin ose zëvendësimin e tyre, pa asnjë kosto shtesë për Autoritetin Kontraktor.

Vendosja e këtij kriteri synon mbrojtjen e interesit publik, sigurimin e cilësisë dhe funksionalitetit të mallrave, si dhe eliminimin e rrezikut të shpenzimeve shtesë nga ana e Autoritetit Kontraktor përfitues.

2.3.8 Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë me anë të së cilës merr përsipër të kryejë shërbimin e transportit, montimit si dhe vendosjen nëpër vende në adresat e përcaktuara nga Autoritetet Kontraktore përfituese.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe nenit 40, pika 8, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar.

2.3.9 Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë, me anë të së cilës konfirmon se artikujt objekt i prokurimit do të jenë të reja, të papërdorura më parë, të prodhuar sipas standardeve të cilësisë në fuqi dhe pa asnjë lloj dëmtimi estetik apo strukturor.

Argumentimi: Ky kriter është përcaktuar në bazë të nenit 77, pika 4, të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020, “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar), si dhe pikës 8 të nenit 40 të VKM nr. 285,

datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. Përmes këtij kriteri, synohet që operatorët ekonomikë të garantojnë furnizimin e mallrave në përputhje të plotë me specifikimet teknike të përcaktuara në DST.

Deklarata e kërkuar shërben si garanci për Autoritetin Kontraktor se produktet e furnizuara do të jenë të cilësisë së kërkuar, të paprekura nga dëmtime estetike apo strukturore, dhe të prodhuara sipas standardeve në fuqi. Gjithashtu, ajo siguron se mallrat do të dorëzohen në ambientet e Autoritetit Kontraktor në gjendje të përsosur, duke eliminuar rrezikun e furnizimit me artikuj të përdorur, të konsumuar apo të dëmtuar, që do të çënonin cilësinë dhe funksionalitetin e tyre. Ky kriter është vendosur si masë mbrojtëse për interesin publik dhe për të garantuar se fondet e prokurimit do të përdoren për furnizime të reja, funksionale dhe të qëndrueshme, në përputhje me nevojat institucionale të Autoritetit Kontraktor.

2.3.10 Operatori ekonomik duhet të ketë një ambient ku ushtron veprimtarinë, sipas objektit të prokurimit, prodhim ose shitje/ tregetim/ mobilje/ pajisje zyre, për të cilën duhet të paraqesë:

- Akt pronësie, kontratë qiraje apo përdorimi i regjistruar në QKB, si ambient ku ushtron aktivitetin.

Argumentim: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77 të ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe në nenin 40 pika 5 të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar; Ky kriter vendoset në përputhje të plotë vlerën dhe sasinë e mallrave objekt prokurimi, si dhe me afatin e lëvrimin të mallit. Kjo kërkesë mbështetet në disa faktorë kryesorë që sigurojnë cilësinë e produktit, kapacitetin për përmushjen e kontratës në kohë dhe përmbushjen e standardeve teknike. Një ambient i përshtatshëm për prodhimin ose tregtimin e mallrave objekt prokurimi, mundëson kapacitetin e nevojshëm për të prodhuar apo tregtuar në mënyrë të qëndrueshme, pa ndërprerje ose vonesa dhe sipas standardeve të kërkuara, gjë që ndihmon në realizimin në afatet e caktuara të kontratës. Një ambient i përshtatshëm për prodhimin dhe tregtimin e mobiljeve është i pajisur me infrastrukturën dhe masat e sigurisë, që garantojnë mirëqënien dhe sigurinë e punonjësve, që ndikon drejtpërdrejt në vazhdimësinë e prodhimit ose tregtimit, me qëllim realizimin në kohë dhe me cilësi të objektit të prokurimit. Gjithashtu një ambient i përshtatshëm ndikon në kushtet e ruajtjes të mallit, të cilat ndikojnë në cilësinë e produkteve, pasi ekspozimi ndaj lagështirës, pluhurit ose temperaturave të papërshtatshme mund të dëmtojë mallrat objekt prokurimi dhe të ulë jetëgjatësinë e tyre.

Ofertuesve nuk u lejohe të mbështeten në kapacitetet e operatorëve të tjerë për plotësimin e kërkesave për kualifikim, argumentimi sipas pikes 2.16 “Mbështetja në kapacitete në subjekte të tjera”, faqet 11-16 faqe në DST (Dokumenta Standarte të Tenderit).

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Kriteret për kualifikim vendosen me qëllim që t'i shërbejnë Autoritetit Kontraktor në njohjen dhe vlerësimin e gjendjes reale, kapaciteteve dhe aftësive të operatorëve ekonomikë që marrin pjesë në procedurën e prokurimit. Përmes dokumentacionit të paraqitur, operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike dhe profesionale, kapacitetet ekonomike dhe financiare, si dhe strukturën organizative të përshtatshme për realizimin e kontratës.

Këto kritere synojnë të garantojnë se operatorët ekonomikë kanë në dispozicion makineritë, pajisjet dhe asetet e tjera fizike të nevojshme, si dhe disponojnë reputacionin, besueshmërinë dhe përvojën e duhur në fushën përkatëse. Po ashtu, një element thelbësor është disponueshmëria e personelit të kualifikuar dhe të specializuar, i cili është i domosdoshëm për zbatimin e kontratës në përputhje me specifikimet teknike dhe kushtet e përcaktuara nga Autoriteti Kontraktor.

Vendosja e kritereve të tilla garanton transparencë, barazi dhe konkurrencë të ndershme ndërmjet operatorëve ekonomikë, duke siguruar se kontrata do të realizohet me sukses, me cilësi të lartë dhe brenda afateve të përcaktuara ligjërisht. Kështu, këto kritere nuk përfaqësojnë vetëm një mekanizëm formal verifikimi, por janë një instrument ligjor dhe praktik që i shërben mbrojtjes së interesit publik, përdorimit me eficiencë të fondeve publike dhe përmbushjes së objektivave të Autoritetit Kontraktor.

Operatorët ekonomikë të huaj duhet të paraqesin gjithë dokumentacionin e tyre në gjuhën shqipe ose në gjuhën angleze dhe të pajisur me vulën "Apostille". Për shtetet që nuk e kanë ratifikuar Konventën e Hagës, datë 5 tetor 1961, "Për heqjen e kërkesës për legalizim diplomatik ose konsullor të dokumenteve zyrtare të huaja", dokumentet duhet të legalizohen pranë ambasadave, konsullatave ose zyrave përkatëse të vendit të origjinës. Mospërmbushja e këtij kriteri përbën shkak skualifikim.

II. ARGUMENTIMI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Për hartimin e specifikimeve teknike për mobilimin e godinave në përdorim nga Fakulteti i Mjekësisë, Fakulteti i Mjekësisë Dentare dhe Rektorati i Universitetit të Mjekësisë Tiranë specifikimet teknike janë marrë nga katalogu i Operatorit të Blerjeve të Përqëndruara "Blerje orendish dhe pajisjesh për mobilim", viti 2025 si dhe nga projektet e godinave, në përputhje me nenin 36 të Ligjit nr. 162/2020, "Për Prokurimin Publik", të ndryshuar, si dhe nenin 40 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", të ndryshuar.

Specifikimet teknike pjesë e shtojca 6 e DST.

Parametrat e përcaktuar si fikse në specifikimet teknike nuk janë vendosur në mënyrë arbitrare apo kufizuese, por janë të domosdoshëm për të garantuar përputhshmërinë e mobilimit me dimensionet ekzistuese të ambienteve ku do të montohen.

Për këtë arsye, përcaktimi i parametrave fikse është i justifikuar plotësisht nga pikëpamja teknike dhe funksionale dhe është në përputhje me nenin 78 të VKM nr. 285, datë 19.5.2021, i ndryshuar, pasi synon garantimin e cilësisë së objektit të tenderimit dhe realizimin e saktë të mobilimit, pa pasur për qëllim favorizimin apo përjashtimin e operatorëve ekonomikë të caktuar, duke respektuar parimet e konkurrencës, trajtimit të barabartë dhe transparencës. Ky proces është zhvilluar duke

respektuar parimin e ligjshmërisë dhe të transparencës, me qëllim garantimin e standardeve të kërkuara për realizimin e suksesshëm të objektit të prokurimit.

Specifikimet teknike të hartuara përmbajnë tërësinë e elementeve më të rëndësishme dhe përbërëse, të cilat sigurojnë cilësinë, funksionalitetin dhe përshtatjen e plotë me nevojat e Autoritetit Kontraktor. Ato janë konceptuar jo vetëm si përshkrime të thjeshta të produkteve, por si një instrument ligjor dhe teknik, i cili lidh në mënyrë të drejtpërdrejtë kërkesat e Autoritetit Kontraktor me detyrimet e operatorëve ekonomikë që marrin pjesë në procedurë.

Autoriteti Kontraktor, duke u bazuar në nevojat konkrete të institucionit dhe në respektim të plotë të kuadrit ligjor në fuqi. Ky harmonizim siguron që procesi i prokurimit të jetë në përputhje me praktikatat më të mira të konsoliduara dhe të shmangen interpretimet subjektive apo specifikimet e panevojshme që mund të kufizonin konkurrencën.

Nga ana teknike, specifikimet janë ndërtuar në mënyrë që të garantojnë performancë të qëndrueshme të produkteve në përdorim afatgjatë, duke përcaktuar parametrat kryesorë si qëndrueshmëria e materialeve, rezistenca ndaj konsumimit, përputhshmëria me standardet e sigurisë, ergonomia dhe mirëfunksionimi në kushtet konkrete të përdorimit. Këto elemente teknike sigurojnë jo vetëm cilësinë dhe jetëgjatësinë e produkteve, por edhe uljen e kostove të mirëmbajtjes apo zëvendësimit të parakohshëm, duke i bërë furnizimet më efikase për Autoritetin Kontraktor.

Specifikimet teknike shprehin tërësinë e elementeve thelbësore që garantojnë cilësinë e kërkuar dhe sigurojnë përputhshmërinë e plotë të furnizimeve me funksionet e parashikuara nga Autoriteti Kontraktor, duke garantuar kështu zbatimin korrekt, me cilësi dhe në afatet e përcaktuara të kontratës.

Në vijim, sqarojmë se, siç është bërë e qartë edhe në dokumentet e tenderit, kriteret, specifikimet teknike, preventivat dhe çdo përcaktim tjetër i përfshirë në to përfaqësojnë kërkesat minimale të Autoritetit Kontraktor. Në respekt të nenit 36 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 ‘Për prokurimin publik’, i ndryshuar, në të gjitha rastet kur në dokumentet e tenderit përmendet ‘markë’, përfshihet termi ‘ose ekuivalenti i tij/saj’. Po ashtu, kudo në specifikimet teknike ku është cituar një standard ndërkombëtar, do të pranohet edhe cilësimi ekuivalent i lëshuar nga një institut vendor.”

Transporti/montimi dhe vendosja e mallrave objekt prokurimi në ambjentet e përcaktuara nga Autoriteti Kontraktor përfitues do të realizohet nga operatori ekonomik fitues.

Për të krijuar dosjen e tenderit në sistemin e prokurimit elektronik të APP dhe për të ngarkuar të gjithë dokumentacionin e procedurës së prokurimit Njësia e Prokurimit autorizoi personin përgjegjës për prokurim.

NJËSIA E PROKURIMIT: